



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Lënda: Ftesë për negociatë, “Për prodhimin e një fushate komunikimi për tatimpaguesit”.

Drejtuar: Organeve të Masmedias/Agjensive të Specializuara

Bazuar në Vendimin Nr. 1195, datë 05.08.2008, të Këshillit të Ministrave “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetim nga Operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e Administratës Shtetërore”, pika 9, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ju dërgon këtë ftesë për pjesëmarrje për realizimin dhe prodhimin e një fushate komunikimi.

Kërkojmë të na vini në dispozicion ofertën tuaj për shërbimin e kërkuar, sipas përcaktimeve më poshtë:

- 1- Prodhimin në total të 7 (shtatë) spoteve informuese / ndërgjegjësuere në kuadër të fushatës së sensibilizimit dhe ndërgjegjësimi të tatimpagueseve me objekt: “Kanalet informuese dhe shërbimet e Tatimeve”:
 - 2 (dy) spote informuese për procesin e Fiskalizimit.
 - 2 (dy) spoteve informuese për luftën kundër informalitetit.
 - 1 (një) spoti informues për shërbimet tatimore online të ofruar nga AT, asistenca dhe orientimi për tatimpaguesit.
 - 1 (një) spoti informues për plotësimin online të DIVA 2021 dhe kategoritë që kanë detyrimin ligjor plotësimin e saj.
 - 1 (një) spoti informues për kanalet informuese të komunikimit të AT.
- 2 Spotet të jenë me grafikë të dizenuar, xhirim me personazhe dhe animacion me skenarë (në përputhje me përmbajtjen dhe kontekstin).
- 3 Kohëzgjatja e spotit të jetë jo më pak se 45 sekonda.
- 4 Produktet finale do të jenë në DVD Master, Audio DS, Format Video HD 1080.
- 5 Kohëzgjatja e fushatës do të jetë 60 ditë, nga data e lidhjes së kontratës.
- 6 Të gjitha spotet duhet të përmbajnë logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Fondi Limit në dispozicion për prodhimin e materialeve të mësipërme, do të jetë **8 190 000 (tetë million e njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, 9 828 000 (nëntë million e tetëqind e njëzet e tetë mijë) lekë me TVSH.**

Afati i fundit për paraqitjen e ofertave, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në zyrën e Protokollit, nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara, është data 12.09.2022 ora 08:30. Paraqitja e ofertës pas këtij orari nuk do të pranohet.

Organi i masmedias/Agjencia e specializuar që do të paraqesë konfirmimin për vazhdimësinë e negociatave, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë i regjistruar pranë Administratës tatimore me status aktiv.
- Te kete dorezuar pasqyrat financiare te vitit 2021.
- Të mos jetë në proces falimentimi.
- Të mos ketë detyrime tatimore të papaguara perfshire detyrime të sigurimeve shëndetësore & shoqërore.
- Të mos jetë i dënuar me vendim Gjykate të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.
- Të mos jetë i dënuar për shkelje penale në përputhje me nenin 76 të Ligjit 162/2020 për Prokurimin Publik.
- Fusha e veprimtarisë të jetë në përputhje me kërkesat e paraqitura në këtë “Ftesë për negociatë”.
- Shërbimet të realizuara të së njëjtës natyrë, të vërtetuara me faturë tatimore.
- Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik, që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.

Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme përbën kusht për skualifikimin e ofertuesit. Dokumentat që vërtetojnë plotësimin e kriterëve, të siguruara jo më parë se 3 muaj nga dita e hapjes së ofertës duhet të paraqiten në formë origjinale ose kopje të noterizuara. (përvec dokumentit që vërteton se subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara, i cili i referohet detyrimeve në kohë reale).

Specifikimet teknike për prodhimin e spoteve informuese janë:

1. Cilësia e kërkuar sipas kriterëve të mëposhtme:
 - a) 7 spotet të jenë më grafikë të dizajnuar, xhirime me personazhe dhe animacion me skenarë (në përputhje me përmbajtjen dhe kontekstin)
 - b) Video: të paktën 90% e të gjitha shkrepeve të jenë të qarta, të ndriçuara mirë dhe të qëndrueshme. Nuk duhet të kenë tranzicione tepër shpërqendruese të skenës ose kënde të kamerës.
 - c) Audio: në rast se do të ketë dialogje dhe fjalime, ato duhet të regjistrohen me një mikrofon të dedikuar. Niveli i volumit gjatë gjithë videos duhet të jetë i qëndrueshëm. Zhurma e sfondit dhe era, si dhe muzika, nuk duhet të shpërqendrojnë.
 - d) Skema e tregimit/ historisë/ spotit duhet të jetë e qëndrueshme, me një fillim, një seksion të mesëm dhe një përfundim, zakonisht duke paraqitur një problem, veprim të ndërmarrë dhe rezultate të marra.
 - Teksti grafik dhe titrat duhet të lexohen në ekran.
 - Mesazhet e përgjithshme duhet të jenë të qarta dhe ritmi tërheqës.
2. Specifika teknike të regjistrimit:
 - a) Pamjet
Pamjet video nuk duhet të përfshijnë vetëm imazhe që mbulojnë një projekt specifik, por edhe pamje të përgjithshme të njerëzve në mjediset urbane, të zyrës etj.
 - b) Marrëveshja e licencimit të muzikës

Duhet patjetër të keni një marrëveshje të licencimit të muzikës (ose vërtetim të pagesës së muzikës që do të përdoret) për përdorim të pakufizuar në të gjitha mediat në të gjithë botën në përjetësi, duke përfshirë platformat online si YouTube.

c) Kompresimi

Duhet ruajtur i njëjti konfigurim për të gjithë procesin (importimi, modifikimi, konvertimi).

d) Audio

Duhet të jetë një përzierje e plotë: tingull natyral, digjitale, rrëfim në formën e voice over ose intervistë

e) Produktet që duhet të dorëzohen:

Video e edituar për website dhe youtube

Video për social media

Video në hard drive

Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave:

Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha në një ditë të vetme, të mbyllura në zarf jotransparent, të firmosur, vulosur, me emrin dhe adresën e subjektit negociues, me shënimin “Mos e hapni, me përjashtim të rastit kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës 12.09.2022, ora 08:30”. Ato duhet të dorëzohen nga përfaqësuesit e operatorit ekonomik, pranë zyrës së protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, brenda orës në datën e përcaktuar. Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe nuk do të merren për shqyrtim.

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në monedhën Lek pa TVSH dhe TVSH do të jetë e përcaktuar në një zë të vecantë në ofertë.

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Adresa: Rruga Gjin Bue Shpata, Tirana 1000

Adresa e Internetit: www.tatime.gov.al

Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr. 1195, datë 05.08.2008.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave me përfaqësuesit e tyre ligjorë ose me personat e autorizuar me autorizimin përkatës.

Mbetemi në pritje të ofertave tuaja,

Faleminderit.